

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA EKONOMISE PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT  
DREJTORIA E PRIVATIZIMIT TE NDERMARRKJEVE DHE SHOQERIVE  
TE VOGLA DHE TE MESME

U R D H E R  
Nr. 5/1 Date. 21.08 2000.

PER  
ZMADHIMIN E KAPITALIT THEMELTAR TE "SUPERFOSFATI SH.A  
KURBIN

Ne baze te paragrafit te pare te nenit 2 te Ligjit Nr.8237,  
date 1.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr.7926, date  
20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne  
shoqeri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr. 1195 date  
14.08.1995, Ligjin Nr 8099 date 28.03.1996 , Dekretin Nr  
1631 date 1.11.1996, Ligjin nr 8158, date 7.11.1996 dhe  
nenit 152 te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite  
tregtare", me cilesine e aksionerit te vetem

U r d h e r o j :

1-Te zmadhohet kapitali themeltar i "Superfosfatit "sh.a  
Kurbini 455.000.000 leke ne 457.895.200 leke nepermjet  
zmadhimit te numrit te aksioneve qe perbejne kapitalin e  
shoqerise, nga 455.000 ne 457.895 aksione :

2-Te behen ndryshimet si meposhte ne piken 4 te Aktit te  
Themelimit dhe ne nenin 3 te statutit:  
Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 457.895.200 leke  
Numri I aksioneve eshte 457.895

3-Ngarkohet Drejtoria e Privatizimit te Ndermarrjeve dhe  
Shoqerive te Vogla dhe te Mesme dhe Drejtoria e Shoqerise  
te bejne veprimet perkatese ne perputhje me parashikimet e  
nenit 33 te Ligjit nr.7667 date 28.01.1993 "Per regjistrin  
tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite  
tregtare.



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA EKONOMISE PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT  
DREJTORIA E PRIVATIZIMIT TE NDERMARRKJEVE DHE SOQERIVE  
TE VOGLA DE TE MESME

U R D H E R  
Nr. 360 Date. 13.7 2000.

PER  
ZMADHIMIN E KAPITALIT THEMELTAR TE SH.A ``SUPERFOSFATI``  
KURBIN

Ne baze te paragrafit te pare te nenit 2 te Ligjit Nr.8237,  
date 1.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr.7926, date  
20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne  
shoqeri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr.1195 date  
14.08.1995, Ligjin Nr 8099 date 28.03.1996, Dekretin Nr.1631  
date 1.11.1996, Ligjin nr.8158 date 7.11.1996 dhe nenit 164  
te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare",  
me cilesine e aksionerit te vetem

U r d h e r o j :

1- Te zmadhohet kapitali themeltar i shoqerise anonime  
``Superfosfati`` Kurbin per:

a) Vleren e objektit Depo e Lendes se Pare, aktualisht prone  
e Ndermarrjes shteterore ``Uzines se Superfosfatit`` Kurbin.

2- Ekspert kontabel e autorizuar Zj.Mimoza Lengo te  
pergatise raportin per zmadhimin e kapitalit ne perputhje  
me piken 1 te ketij urdheri.

3. Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.



**EKA MIMOZA LENGO**  
**TIRANE**

**DEKLARATE**

*Me anen e se ciles deklaroj se, ne zbatim te rregullave te deontologjise te percak-tuara ne VKM Nr.150 date 31.03.2000 Neni 55,ne kohen e emerimit dhe gjate mandatit te ekspertit kontabel te autorizuar ne ShA "Superfosfati" Kurbin kam qene dhe jam e pavarur nga shoqeria dhe nga drejtuesit e saj dhe asgje nuk i ka sjelle dem pavaresise dhe ndershmerise time.*

DEKLARUESJA

(Mimoza Lengo)



**RAPORT I EKSPERTES KONTABEL TE AUTORIZUAR  
PER ZMADHIMIN E KAPITALIT THEMELTAR TE  
ShA "SUPERFOSFATI" KURBIN NEPERMJET  
KONTRIBUTIT NE NATYRE**

Une e nenshkruara MIMOZA LENGO, Eksperte Kontabel e Autorizuar e rregjistruar me Nr.28 ne Listen e EKA-ve te hartuar per vitin 2000 nga IEKA Tirane, banuese ne Tirane, e caktuar me cilesine e Ekspertes te kontributeve ne natyre, ne zbatim te Nenit 150 dhe Nenit 162 te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 me Vendim Nr. \_\_\_\_\_ date \_\_\_\_\_ 2000 te Gjykates se Rrethit Tirane dhe mbeshtetur ne Urdherin Nr.360 date 13.07.2000 te Ministrise Ekonomise dhe Privatizimit, jam caktuar te hartoj nje raport per vleresimin e kontributeve ne natyre per zmadhimin e kapitalit themeltar te ShA "Superfosfati" Kurbin.

Per sa me siper raportoj se kam ndjekur ne vend punen e komisionit te krijuar lidhur me vleresimin e kontributit ne natyre si vijon:

- Objekti Nr.261 Depo e lendes se pare te Superfosfatit Nr.2 qe perbehet nga

a- Ndertesa 22.309.268 leke

b- Makineri e paisje 487.988 leke

Vlera fillestare e objektit 22.797.256 leke (e rivleresuar)

Amortizimi 6.839.176 leke "

(Shih proces verbalin e dates 18.07.2000 te bashkengjitur) ✓

Rregjistrimet kontabel te veprimeve lidhur me zmadhimin e kapitalit themeltar nepermjet kontributit ne natyre jane kryer ne menyre te plote e te rregullt.

**Bilanci i transformuar i shoqerise pas zmadhimit te kapitalit themeltar jep nje pamje besnike te pasurise dhe te gjendjes financiare te shoqerise.**

**Kapitali themeltar i zmadhuar nepermjet kontributit ne natyre 457.895.200 leke dhe Rezerva nga rivleresimi 93.879.531 leke i pergjigjet edhe zmadhimi i Aktiveve te Qendrushme neto 362.278.911 leke.**  
Tirane me 19 Korrik 2000

**EKSPERTE KONTABEL E AUTORIZUAR**

**MIMOZA LENGO**

  
Eksperte Kontabel e  
AUTORIZUAR  
MIMOZA LENGO  
TIRANE

## PROÇES - VERBAL

I mbajtur sot me dt 18.07.2000 ne SH.A. "Superfosfatin" Kurbin per vleresimin e objektit me numer pozicioni 261 (depo e lendes se pare te Superfosfatit Nr= 2) nga komisioni i vleresimit i perbere nga z.Gjergj JAKU K/Ing ,z.Bardhok PRENGA K/Deges Teknike,z.Selman MIHANA K/Deges Finances,znj.Floresha ISUFI Teknike ndertimi nga njera ane dhe znj.Mimoza LENGO Eksperte Kontabel per vleresimin e kontributeve.

Ky vleresim behet me urdher te M.E.P.P nr.360 dt.13.07.2000 ,bazuar ne shkresen nr.4950/1 dt 10.07.2000 te Drejtorise se Pergjithshme te Industrise ne M.E.P.P. te shkresen nr.104. dt. 26.06.2000 te SH.A."Superfosfatit" Kurbin dhe Usines se Superfosfatit Laç dhe vendimit nr.11 te Keshillit Mbikqyres te SH.A."Superfosfatit"Kurbin dt.04.07.2000 .

Per kalimin e ketij objekti aktualisht prone e ndermarrjes Shteterore te Uzines Superfosfatit Laç ,ne pronesi te SH.A."Superfosfatit" Kurbin,komisioni pasi berei verifikimin ne vend te objektit te mbeshtetur ne V.K.M nr.194 dt 20.03.1998 konkludoi si me poshte:

1 - Objekti nr.261 (depo e lendes se pare te Superfosfatit nr=2) ish prone e Uzines se Superfosfatit Laç perbehet nga :

- a - Ndertesa 3 635 m<sup>2</sup>
- b - Makineri paisje
  - Bunker ushqimi 3 x 4 m cope 1(nje)
  - Bunker pluhuri (minerali) 3 x 4 m cope 1 (nje)

Lidhur me vleresimin e ketyre aktiveve te qendrushme paraqiten ne tabelen e me poshtme:

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia	V. perdorimi	Vlera fillestra e kontabel (bruto)	Amortizimi kontabel	Indeksi i vleresimit	vlera fillestra e rivleresuar	Amortizimi i rivlere suar	Diferenca e rivleresimit	
										V.filles tare	Amortizimi
	a	b	1	2	3	4	5	6	7	8=(6-3)	9=7-4
1	Ndertesa	cop	1	11	4131346	1239404	5.4	22309268	6692782	18177922	5453378
2	Makineri paisje	-	-	-	90368	27110	5.4	487988	146394	397620	119284
	Bunker ushqimi	cope	1	11	45184	13555	5.4	243994	73197	198810	59642
	Bunker pluhuri	"	1	11	45184	13555	5.4	243994	73197	198810	59642
	<b>Totali</b>				<b>4221714</b>	<b>1266514</b>	<b>5.4</b>	<b>22797256</b>	<b>6839176</b>	<b>18575542</b>	<b>5512662</b>

Ky vleresim eshte bere ne mbeshtetje te V.K.M nr.194 dt.20.03.1998 dhe per indeks te vleresimeve te tyre eshte marre indeksi i muajit Korrik 1996,periu dhe ne te cilen eshte kryer vleresimi i aktivave te qendrushme te SH.A."Superfosfatit"Kurbini.

#### K O M I S I O N I

Gjergj JAKAJ



Bardhok PRENGA



Selman MIHANA



Floresha ISUFI



Eksperti Kontabel i autorizuar

Mimoza LENGU

  
Eksperte Kontabël e  
AUTORIZUAR  
MIMOZA LENGU/  
TIRANË

